



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3942 Prot.

Ballsh më, 26 / 11 /2021

VENDIM

Nr. 47 Datë 25 / 11 /2021

“PËR

PAGESËN E VLERËS SË QIRASË SË FAMILJES TË Z.FERRO MUHARREM BEQIRAJ, BANOR I FSHATIT NGRAÇAN, NJËSIA ADMINISTRATIVE NGRAÇAN, FAMILJES SË Z. XHEVAT SHEME HALIMI, BANOR I FSHATIT KLOS, NJËSIA ADMINISTRATIVE HEKAL, BASHKIA MALLAKASTËR”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3, gërma d, Ligjit Nr.22/2018, “Për strehimin social”, evidentimeve të kryera nga ana e strukturave të Bashkisë Mallakastër në lidhje me vështirësitë financiare për shkak të dëmtimeve totale të banesave të familjeve të sipërcituara,

VENDOSI

1. Pagesen e vlerës së qirase për familjen e **Z. Ferro Muharrem Beqiraj**, banor i fshatit Ngraçan, Njësia Administrative Ngraçan, Bashkia Mallakastër, familje e cila i është dëmtuar totalisht banesa (e pabanueshme) nga rrëshqitja e tokës dhe ndodhet në kushte të vështira jetese . Vlera e qirase e propozuar është deri në masën 10, 000 (dhjete mijë) lekë në muaj për një periudhë 1 vjeçare, (12 muaj), me të drejtë rinovimi (në rast disponibiliteti financiar të Bashkisë Mallakastër). Pagesa financiare do të paguhet pas lidhjes së kontratës së qirasë midis banorit dhe qiradhënësit të banesës.
2. Pagesen e vlerës së qirase për familjen e **Z. Xhevat Sheme Halimi**, banor i fshatit Klos, Njësia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër, familje e cila i është djegur totalisht banesa dhe ndodhet në kushte të vështira jetese. Vlera e qirase e propozuar është deri në masën 10, 000 (dhjete mijë) lekë në muaj për një periudhë 1 vjeçare, (12 muaj), me të drejtë rinovimi (në rast disponibiliteti financiar të Bashkisë Mallakastër). Pagesa financiare do të paguhet pas lidhjes së kontratës së qirasë midis banorit dhe qiradhënësit të banesës.
3. Shpenzimet e vlerave të qirasë do të mbulohen nga të ardhurat e Bashkisë Mallakastër.

KRYETAR

Mbarime Isufaj